



the institute
of economics,
zagreb



STUDIMI I VENDIT: KOSOVË



Zagreb, 2019

Instituti i Ekonomisë, Zagreb

Trg J. F. Kennedyja 7
10000 Zagreb, Kroaci

AUTORËT

Jelena Budak
Goran Buturac
Davor Mikulić
Edo Rajh
Sunčana Slijepčević

DEZAJNI

Vladimir Sukser

EDITORI TEKNIK

Vladimir Sukser

PËRKTHIMI DHE KOPJEDITIMI

Sinonim Translations

ANKETË

Hendal d.o.o.

Opinionet e shprehura në këtë studim janë ato të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit të Ekonomisë, Zagreb. Ky studim është pjesë e projektit kërkimor "Tregtia e paligjshme e produkteve të duhanit: Kontrabanda si e përjetuar përgjatë Rrugës Ballkanike - BalkanSmugg", financuar nga PMI IMPACT - një iniciativë e grantit global nga Philip Morris International (PMI) për të mbështetur projektet e kushtuara luftës kundër tregtisë së paligjshme dhe krimeve të lidhura me të. Në kryerjen e hulumtimit, autorët mbajtën pavarësi të plotë nga PMI. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e PMI-së.

Përmbajtja

Gjetjet kryesore	2
1. Hyrje	4
2. Zakonet e duhanpirjes	5
3. Zakonet e blerjes: tregu i ligjshëm apo gri – tregu i zi	7
4. Disponueshmëria e cigareve dhe duhanit të prerë në tregun gri	10
5. Dalja nga tregu gri	12
6. Ndjeshmëria e çmimeve të konsumit të produkteve të duhanit	14
7. Tregtia nderkombetare e produkteve të duhanit	16
8. Puna e padeklaruar	18
9. Papranueshmëria e disa praktikave të tregtisë së duhanit të paligjshëm	20
10. Perceptimet dhe opinionet publike për tregun gri	21
Shtojca	23

Gjetjet kryesore

- Nga 41 përqind e popullatës së rritur të duhanpirësve në Kosovë, 94 përqind blejnë produkte duhani në dyqanet e autorizuara. 99 përqind tymosin cigaret e prodhuara industrialisht, dhe 4 përqind blejnë duhanin e prerë për të dredhur dhe mbushur vetë cigaret.
- Nëntë nga dhjetë blerës në tregun gri blejnë cigaret e prodhuara industrialisht; kjo e bën cigaren produktin kryesor të paligjshëm të duhanit në Kosovë.
- Duhanpirësit u zhvendosën në tregun gri të produkteve të duhanit për shkak të komoditetit dhe dy të tretat e tyre bëjnë blerjet e përditshme në tregun gri.
- Gjithsej 87 përqind e duhanpirësve që blejnë në tregun gri theksojnë se arsyeja kryesore pse ata filluan të blejnë në tregun gri është blerja më e lehtë dhe çmimi më i mirë i produkteve të duhanit është motivi kryesor për blerjen në tregun gri për 12 përqind të duhanpirësve.
- Gjysma e blerësve do të dilte nga tregu gri vetëm nëse do të linin duhanin. Përndryshe, derisa tregu gri ekziston, do të jetë vendi më i preferuar i blerjes për shumicën e duhanpirësve të përfshirë në tregtinë e paligjshme në Kosovë. Ndëshkimi më i lartë do të funksiononte për 30 përqind të tyre që të kalonin në tregun e produkteve të ligjshëm të duhanit dhe ndryshimi i çmimeve është faktor më pak i rëndësishëm në Kosovë sesa në rajon.
- 75 përqind e blerësve do të reduktonte konsumin e duhanit të prerë në tregun e gri nëse çmimi i cigareve të ligjshme do të ullej. Kjo tregoi se për shumicën e blerësve, duhani i prerë në tregun gri dhe cigaret e prodhuara industrialisht në tregun ligjor janë zëvendësues në Kosovë. Përkundrazi, vetëm 30 përqind e konsumatorëve do të ulte konsumin e cigareve të paligjshme në qoftë se çmimi i cigareve të blera ligjërisht zvogëlohet dhe bëhet i barabartë me çmimin e cigareve të blera në tregun gri.
- Gjashtë nga dhjetë blerës në tregun gri do të kërkonin një vend të ri blerjesh brenda tregut gri, nëse për disa arsye, ata nuk mund të blinin produkte të duhanit të paligjshëm në vendin e tyre të zakonshëm.
- Pikat më të zakonshme të shitjes në tregun gri janë rishitësit në rrugë, ndjekur nga dyqanet e shitjes së produkteve të duhanit nën dorë. Duke qenë se të gjithë duhanpirësit i kryejnë blerjet e tyre brenda vendit, mund të thuhet se tregu gri i produkteve të duhanit funksionon mirë në Kosovë.
- Disponueshmëria e produkteve të duhanit në tregun gri u rrit gjatë dy viteve të fundit. Meqë 42 përqind e duhanpirësve e kanë vlerësuar si më të mirë disponueshmërinë e cigareve në tregun gri dhe 20 përqind e duhanpirësve e kanë vlerësuar disponueshmërinë e duhanit të prerë në tregun gri, nuk ka tregues për një rënie në furnizimin e produkteve të duhanit të paligjshëm në Kosovë.

- Kosova është importues absolut i produkteve të duhanit dhe bilanci negativ i tregtisë së duhanit është i barabartë me vlerën e importit, rreth 62 milionë euro në vitin 2017.
- Tregu i zi dhe puna e padeklaruar janë të lidhura ngushtë, dhe studimi na ka mundësuar vlerësimin e ofertës dhe kërkesës për punë të padeklaruar në Kosovë. Rreth 4 përqind e të anketuarve kishin blerë mallra që, siç supozojnë, janë prodhuar nga puna e padeklaruar. Më pak se 1 përqind e të anketuarve kanë raportuar se janë paguar për punë të padeklaruar në 12 muajt e fundit. Popullsia e moshuar me të ardhura të ulëta nuk ngurron të deklarojë ndonjë pjesëmarrje si në anën e ofertës dhe kërkesës së punës së padeklaruar në Kosovë.
- Ekziston një konsensus i fortë publik në Kosovë se tregtia e paligjshme është e dëmshme. Për shumicën e qytetarëve në Kosovë (mbi 90 përqind) transaksionet në tregun gri të produkteve të duhanit janë gabime të papranueshme dhe blerja e produkteve të duhanit në tregun gri nuk është e pranueshme për 68 përqind të qytetarëve.
- Dy të tretat e personave në Kosovë pajtohen se tregu gri i produkteve të duhanit shkakton dëme të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe se kontrabanda e produkteve të duhanit është një pjesë integrale e krimit të organizuar.

1. Hyrje

Tregtia ilegale, tregu gri dhe kontrabanda e duhanit kanë qenë për një kohë të gjatë të pranishme në rajonin e Ballkanit. Projekti i studimit **‘Tregtia e paligjshme e produkteve të duhanit: kontrabanda si e përjetuar përgjatë Rrugës Ballkanike – BalkanSmugg’** e financuar nga PMI IMPACT dhe zbatuar nga Instituti i Ekonomisë, Zagreb, nga korriku 2017 deri në shtator 2019, vlerësoi tregtinë ilegale të cigareve dhe produkteve të tjera të duhanit në shtatë vende përgjatë rrugës së kontrabandës në Ballkan.


Qëllimi specifik i projektit ishte të krijohet një bazë e fortë provash për tregtinë e paligjshme të duhanit në Slloveni, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi, Macedonia Veriore dhe Kosovë. Ndaj, në thelb të këtij hulumtimi është një vlerësim i vëzhgimit të sjelljeve dhe praktikave të duhanpirësve që blejnë cigare në tregun e zi dhe opinioni i qytetarëve lidhur me tregtinë e paligjshme të cigareve dhe produkteve të tjera të duhanit. Në vitin 2018 kemi bërë studimin e 3.000 të anketuarve për çdo vend duke arritur në 21.000 të anketuar në rajon.

BalkanSmugg Studimi i Vendit: Kroacia paraqet gjetjet kryesore lidhur me Kosovën si një nga vendet me interes. Ajo hedh dritë mbi zakonet dhe praktikave të duhanpirësve në blerjen e cigareve dhe duhanit të prerë, duke përfshirë përvojën e blerjes së produkteve të duhanit në tregun gri. Depërtimi në karakteristikat e tregut gri, “paketa” tipike e blerjes mënyra se si duhanpirësit vlerësojnë cilësinë dhe qasjen e produkteve në tregun gri ofrojnë informacion të vlefshëm të dorës së parë. Kemi eksploruar opinionin publik mbi sjelljen e pranueshme lidhur me tregtinë e paligjshme të cigareve dhe produkteve të duhanit dhe perceptimet publike për efektet e saj negative, ndaj projekti ynë është studimi i parë gjithëpërfshirës i tregtisë së paligjshme dhe tregut të zi të cigareve e produkteve të tjera të duhanit në rajonin e Ballkanit që trajton problemin nga këndvështrimi i qytetarëve dhe i konsumatorëve të duhanit. Rezultatet janë paraqitur për Kosovën dhe ishin intuitive, në krahasim me vendet e tjera të vëzhguara, për të inkuadruar kontekstin rajonal të zbulimeve.

Ne shpresojmë që palët e përfshira në këtë projekt dhe krijuesit e politikave do të gjejnë rezultate frymëzuese për luftën kundër tregtisë së paligjshme. Një qëllim përfundimtar i këtij studimi është ngritja e vetëdijes për dëmet e tregtisë ilegale të cigareve dhe produkteve të tjera të duhanit në Kosovë.

2. Zakonet e duhanpirjes

Figura 2.1. **Mbizotërimi i duhanpirjes sipas vendeve**



Burimi: Të dhënat e anketës.


Mbizotërimi i duhanpirjes në Kosovë është 41 përqind.

- Të dhënat e anketës treguan se katër nga dhjetë personat e anketuar janë duhanpirës [Figura 2.1.]. Gjegjesisht, 41 për qind e popullsisë së moshës mbi 18 vjeçare u vetëdeklaruan si duhanpirës, që është mbi prevalencën mesatare të duhanpirjes së të gjithë vendeve të analizuara në rajon [36 për qind].
- Zakon i duhanpirjes është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë tek burrat dhe gratë në Kosovë: ka më shumë se dy herë duhanpirës meshkuj sesa femra. **Pothuajse tre të katërtat e popullsisë mashkullore të rritur në Kosovë pijnë duhan** [Figura 2.2.].

- Produkti më i preferuar i duhanit në Kosovë janë cigaret industriale [Figura 2.3.] të cilat përdoren nga 99 për qind e duhanpirësve. Qartazi, disa duhanpirës kombinonë cigaret me duhanin e prerë, kështu që duhani i prerë përdoret nga më pak se 4 për qind e duhanpirësve që dredhin dhe mbushin cigare të tyre të bëra vetë.


Figura 2.2. **Mbizotërimi i duhanpirjes sipas gjinisë në Kosovë**

Mbizotërimi i duhanpirjes nga meshkujt është shumë i lartë.



Burimi: Të dhënat e anketës.

Figura 2.3. **Duhanpirja sipas llojit të produkteve të duhanit**



99 për qind e duhanpirësve përdorin cigaret e prodhuara industrialisht.


Shënim: Përgjigje të shumëfishta. Në përqindjen e duhanpirësve.
Burimi: Të dhënat e anketës.

3. Zakonet e blerjes: tregu i ligjshëm apo gri – tregu i zi

- Duhanpirësit në Kosovë kryesisht blejnë produkte duhani në dyqanet e autorizuara. Pak më shumë se 6 përqind e duhanpirësve blejnë produktet e tyre të duhanit në tregun gri, që është nën mesataren rajonale prej 11 përqind [Figura 3.1.].
- Në përputhje me zakonet e duhanpirjes, **cigaret industriale janë produkti kryesor i blerë në tregun gri**. Pothuajse 96 përqind e duhanpirësve që blejnë duhanin e tyre në tregun gri përdorin furnizuesit jozyrtarë për të blerë duhan të prerë, dhe 8 përqind e tyre blejnë cigaret industriale [Figura 3.2.].
- Kanali kryesor i tregut gri në Kosovë ku duhanpirësit kryesisht blejnë produkte të duhanit të paligjshëm janë rishitësit në rrugë [73 përqind]. Shitja ilegale në dyqan apo nën dorë është e zakonshme për 23 përqind të duhanpirësve që blejnë në tregun gri në Kosovë. Disi ndryshe nga vendet e tjera në rajon, miqtë dhe të njohurit nuk janë furnizues të produkteve të duhanit në Kosovë [Figura 3.3.].
- Gjithsej 87 përqind e duhanpirësve që blejnë në tregun gri deklarojnë se **arsyeja kryesore pse filluan të blejnë në tregun gri është aksesi më i lehtë**, krahasuar me vendet e tjera ku faktori vendimtar është çmimi më i ulët i produkteve të duhanit. Në Kosovë, çmimi më i ulët është motivi kryesor për blerjen në tregun gri për 12 përqind të duhanpirësve.
- Bblerja në tregun gri nuk lidhet me çmimin konkurrues të produkteve të duhanit, ndryshe në dispozicion në dyqanet e rregullta. Duhanpirësit në Kosovë nuk janë zhvendosur në tregun gri të produkteve të duhanit, pasi cigaret u bënë më të shtrenjta ose për arsye të tjera ekonomike. Shumica dërrmuese e duhanpirësve të produkteve të duhanit të paligjshëm [94 përqind] blejnë në tregun e gri që kur kanë filluar pirjen e duhanit [Figura 3.4.].


6 përqind e duhanpirësve po blejnë në tregun gri.

Figura 3.1. Përqindja e duhanpirësve që blejnë në tregun gri sipas shteteve




Burimi: Të dhënat e anketës.

Figura 3.2. **Produktet e duhanit nga tregu gri**




Shënim: Përgjigje të shumëfishta.
Burimi: Të dhënat e anketës.

Figura 3.3. **Vendi i blerjeve në tregun**



Burimi: Të dhënat e anketës.

Figura 3.4. **Që kur duhanpirësit blejnë produkte duhani në tregjet gri**



Burimi: Të dhënat e anketës.


4.

Disponueshmëria e cigareve dhe duhanit të prerë në tregun gri

- Shumica e duhanpirësve [75 përqind] blejnë çdo ditë në tregun gri [Figura 4.1.].
- Disponueshmëria e produkteve të duhanit në tregun gri është e qëndrueshme për përmirësim [Figura 4.2.].
- **Mbi 40 përqind e duhanpirësve i vlerësojnë cigaret si më të disponueshme në tregun e zi sot** krahasuar me dy vjet më parë, dhe thuhet se 60 përqind e duhanpirësve nuk shohin ndryshime në disponueshmërinë e tyre në tregun e gri për të njëjtën periudhë.
- Një rritje e disponueshmërisë së cigareve në tregun gri sot krahasuar me dy vjet më parë është vërejtur më shpesh në Kosovë sesa në rajon.
- **Disponueshmëria e duhanit të prerë në tregun gri sot është e qëndrueshme gjatë një periudhe 2-vje[are]**, sipas opinionit të thuhet se 72 përqind të duhanpirësve që blejnë në tregun gri. Një në pesë blerës të duhanit të prerë në tregun gri e vlerëson atë si më të disponueshëm.
- Ndryshe nga disponueshmëria e cigareve, një rritje e disponueshmërisë së duhanit të prerë në tregun gri është vërejtur më pak në Kosovë sesa në rajon.


Trendi i perceptuar i rritjes së disponueshmërisë së produkteve të duhanit në tregun gri në Kosovë është më i dukshëm për cigaret sesa duhanin e prerë.

Figura 4.1. **Frekuenca e blerjes në tregun gri**




Burimi: Të dhënat e anketës.

Figura 4.2. **Tendencat në disponueshmërinë e produkteve të duhanit në tregun gri**



Krahasuar me dy vjet më parë:

42 përqind e duhanpirësve e vlerësojnë disponueshmërinë e cigareve si më të mirë në tregun gri.



20 përqind e duhanpirësve e vlerësojnë disponueshmërinë e duhanit të prerë si më të mirë në tregun gri.


Shënim: Krahasuar me dy vjet më parë.
Burimi: Të dhënat e anketës.

5. Dalja nga tregu gri

- Blerësit në tregun gri u pyetën se çfarë do të bënin nëse nuk mund të blinin produkte të duhanit në vendin e tyre të zakonshëm (Figura 5.1.). Pothuajse 60 përqind do të kërkonin një vend të ri blerjesh brenda tregut gri, që do të thotë se përderisa ekziston tregu gri, do të jetë vendi më i preferuar i blerjes për shumicën e duhanpirësve të përfshirë në tregtinë e paligjshme në Kosovë.
- Megjithatë, katër nga dhjetë duhanpirësit që blejnë në tregun gri do të kalojnë në tregun ligjor të produkteve të duhanit (40 përqind). Vetëm dy përqind do të ndalojnë pirjen e duhanit.
- Motivimi për të dalë nga tregu gri i produkteve të duhanit ndryshon mes duhanpirësve në Kosovë. **Gjysma e blerësve do të linin tregun vetëm nëse do të linin duhanin.**
- Faktori i dytë kryesor motivues për daljen nga tregu gri është i lidhur me arsyet ekonomike: 43 përqind do të linin tregun gri nëse standarti i tyre i jetës përmirësohet. Një e treta do ta bënte këtë nëse **kosto e cigareve në tregun e ligjshëm do të ulej.**
- Futja e dënimeve të ashpra për blerje në tregun gri do të motivonte një të tretën e duhanpirësve për të ndaluar blerjen në tregun e gri (Figura 5.2.).

40 përqind e blerësve në tregun gri do të kalonte në tregun e ligjshëm nëse pikat e shitjes ilegale do të ndalonin punën.

Figura 5.1. **Çfarë do të bënin duhanpirësit nëse nuk mund të blinin produktin e paligjshëm të duhanit në vendin e tyre të zakonshëm**




Nëse vendi i zakonshëm për blerje të paligjshme nuk është më në dispozicion, një pjesë e konsiderueshme e duhanpirësve do të kalojë në tregun ligjor.

Burimi: Të dhënat e anketës.

Figura 5.2. **Motivimi për daljen nga tregu gri i produkteve të duhanit**

Ndëshkimi më i lartë do të ishte efikas për mbi 30 përqind të duhanpirësve që të linin tregun gri.



Shënim: përgjigje të shumëfishta.
Burimi: Të dhënat e anketës.


6.

Ndjeshmëria e çmimeve të konsumit të produkteve të duhanit

- Nëse çmimi i cigareve bëhet i barabartë në tregun ligjor dhe atë gri, vetëm 30 përqind e blerësve do të ulte konsumin e tyre të cigareve të paligjshme [Figura 6.1].
- Zvogëlimi i konsumit të cigareve në tregun gri për shkak të çmimeve më të ulëta të cigareve ligjore është më pak i dukshëm në Kosovë sesa në rajon. Pjesa më e madhe [70 përqind] e duhanpirësve që nuk do të ndryshonin konsumimin e tyre të cigareve të paligjshme - edhe nëse ato janë në dispozicion me çmim të njejtë me ato të shitura ligjërisht, është shumë më e lartë sesa mesatarja rajonale.
- Rënia e konsumit të vërejtur për duhanin e prerë është drastike: 75 përqind e blerësve do të ulte konsumin e duhanit të prerë në tregun e gri nëse çmimi i cigareve ligjore do të zvogëlohej [Figura 6.2]. Ndjeshmëria e çmimeve është më e lartë në Kosovë sesa në rajon.
- Kjo tregon se për shumicën e blerësve, duhani i prerë në tregun gri dhe cigaret industriale në tregun ligjor janë zëvendësues në Kosovë.
- **Duhanpirësit në Kosovë tentojnë të zëvendësojnë cigaret e ligjshme me duhan të prerë më të lirë në tregun gri.**

Konsumi i produkteve të duhanit të paligjshëm është rezistent ndaj ndryshimeve të çmimeve të cigareve të blera ligjërisht.

Figura 6.1. **Ndjeshmëria e çmimeve të cigareve të paligjshme**




Burimi: Të dhënat e anketës.

Rënia e çmimit të cigareve të shitura ligjërisht do të çojë në uljen e konsumit të cigareve të paligjshme për 30 përqind të blerësve në tregun gri.

Duhanpirësit në Kosovë tentojnë të zëvendësojnë cigaret e ligjshme me duhan të prerë më të lirë në tregun gri.

Figura 6.2. **Konsumi i duhanit të prerë ilegal**




Burimi: Të dhënat e anketës.

7. Tregtia nderkombetare e produkteve të duhanit

Kosova nuk eksporton produkte duhani, ndaj bilanci i saj i duhanit është negativ.

- Rezultatet e anketimit tregojnë që **duhanpirësit në Kosovë blejnë produkte duhani në pikat e shitjes brenda vendit.**
- **Kosova është një importues neto i produkteve të duhanit dhe eksportet janë të barabarta me zero** [Figura 7.1.].
- Sipas të dhënave më të fundit në dispozicion, importet e produkteve të duhanit janë ulur nga 2013 në 2015-ën. Që atëherë, importet e duhanit po rriten dhe në vitin 2017 kanë arritur rreth 62 milionë euro [Figura 7.2.].
- Për shkak të mungesës së të dhënave, nuk ka analiza të strukturës së tregtisë së duhanit dhe partnerëve kryesorë tregtarë.


Figura 7.1. **Tregtia e duhanit në Kosovë – Bilanci i eksportit, importit dhe tregtisë**



Bilanci negativ i tregtisë së duhanit është i barabartë me vlerën e importit të duhanit.

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në statistikat e UN Comtrade dhe ITC-së.

Figura 7.2. **Importi i duhanit në Kosovë, 2010-2017**




Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në statistikat e UN Comtrade dhe ITC.

8. Puna e padeklaruar

Më pak se 1% e popullsisë së rritur në Kosovë ka raportuar se kanë marrë të ardhura nga puna e padeklaruar në 12 muajt e fundit, ndërsa pothuajse 4% kanë blerë mallra, të cilat siç besojnë, janë prodhuar nga puna e padeklaruar.

- Tregu gri i produkteve të duhanit është pjesë e ekonomisë në hije nga pikëpamja e evazionit fiskal, si dhe për shkak të punës së padeklaruar. Kontrabandistët, shitësit dhe rishitësit e produkteve të duhanit në tregun gri i fitojnë të ardhurat e padeklaruara për shkak të punës së padeklaruar.
- **Shkalla e punës së padeklaruar në Kosovë** vlerësohet nga pikëpamja e kërkesës dhe ofertës në anketë.
- Rezultatet e anketimit treguan se **thujtë 4 përqind e popullatës së rritur në Kosovë kishte blerë disa produkte** për të cilat kishin arsye të mendonin se **të ardhurat nuk ishin tërësisht të raportuara** te institucionet tatimore apo të sigurimeve shoqërore (Figure 8.1.)
- Prirja për të blerë produkte të dorëzuara nga njësitë e angazhuara në punë të padeklaruar nuk është dukshëm e ndryshme për popullsinë mashkullore dhe femërore. Kërkesa për produktet e dorëzuara nga njësitë e angazhuara në punë të padeklaruar është më e theksuar për popullsinë në moshën 18-24 vjeç ku një nga nëntë persona është përfshirë në blerjen e produkteve të supozuara që do të dorëzohen nga sektori i punës së padeklaruar.

Figura 8.1. **Blerësit e produkteve që mund të jenë rezultat i punës së padeklaruar**




Blerësit e produkteve që lidhen me punën e padeklaruar janë personat më të rinj me arsim të mesëm.

Shënim: Përqindja e personave që kanë blerë ndonjë produkt nga të cilat kishin arsye të mirë për të supozuar se vijnë nga punë e padeklaruar.

Burimi: Sondazhi.

- Një fakt interesant në rezultatet e anketimit të Kosovës është **asnjë i anketuar me shkollë fillore, ose më pak, nuk deklaroi të marrë pjesë në kërkesë për produktet e punës së padeklaruar.**
- Sipas vetëdeklarimit të të anketuarve, **më pak se 1 përqind e popullatës së rritur në Kosovë, përveç aktivitetit të tyre të rregullt, ishte paguar për veprimtari pune të padeklaruar** në lek ose në shpërblime në 12 muajt e fundit [Figura 8.2.].
- **Proporcioni i furnizimit me punë të padeklaruar është më i lartë për popullsinë në grupmoshat 25-34 me të ardhura nën mesataren.**
- Si në rastin e kërkesës për mallra të punës së padeklaruar, **asnjë i anketuar me shkollë fillore, ose më pak, nuk raportoi të jetë paguar për aktivitet pune të padeklaruar** në 12 muajt e fundit.
- Ndryshimi midis kërkesës dhe ofertës së punës së padeklaruar mund të tregojë mungesën e besimit në konfidencialitetin dhe anonimitetin e sondazhit që rezultojn në anshmëri të mundshme dhe rënie të shkallës aktuale të pjesëmarrjes në punë të padeklaruar.

Figura 8.2. **Popullsia paguhet për aktivitetet e padeklaruar në 12 muajt e fundit**



Popullsia në moshën 25-34 është furnizuesi kryesor i punës së padeklaruar në Kosovë. Popullsia e moshuar me arsim të ulët deklaroi zero përqindje të pjesëmarrjes në punë të padeklaruar.

Shënim: Individët të cilët përveç veprimtarisë së tyre të rregullt kryejnë aktivitete të padeklaruar në 12 muajt e fundit për të cilat janë paguar në para ose në natyrë.
Burimi: Sondazhi.


9.

Papranueshmëria e disa praktikave të tregtisë së duhanit të paligjshëm

- Shumica e qytetarëve në Kosovë, e konsiderojnë **të papranueshme ose plotësisht të papranueshme blerjen e cigareve kontrabandë** [98 përqind], **cigareve të markave të panjohura pa pullën tatimore** [97 përqind] **ose cigareve të vjedhura** [96 përqind]. Opinioni publik negativ në Kosovë ndahet midis 96 përqind të qytetarëve për shmangien e taksave dhe akcizave mbi produktet e duhanit [Figura 9.1.].
- Në kategorinë e neglizhencës së njohur gjerësisht bie blerja e cigareve pa pullë tatimore, gjë që është e papranueshme për 94 përqind të qytetarëve.
- Sipas mendimit të 68 përqind të qytetarëve, blerja e produkteve të duhanit në tregun gri nuk është i pranueshëm. Gjykimi më pak i ashpër i tregut gri të produkteve të duhanit nuk është në përputhje me pranueshmërinë e neglizhencave të tjera të mbyllura deri në zero, pasi që të gjitha ato lidhen me tregun gri të produkteve të duhanit.
- Dy të tretat e qytetarëve të Kosovës mendojnë se është e pranueshme edhe blerja direkt nga fermerët e duhanit.

Opinioni i fortë negativ i publikut mbi të gjitha praktikatat e tregtisë së duhanit të paligjshëm.

Figura 9.1. **Pranueshmëria e praktikave të caktuara në duhanin e paligjshëm**



Burimi: Të dhënat e anketës.

Publiku në Kosovë e gjykon fort blerjen e cigareve të falsifikuara, pa pullë taksash, ose të vjedhura.

Blerja e produkteve të duhanit në tregun gri në përgjithësi nuk është i pranueshëm për 68 përqind të qytetarëve.

35 përqind e miratojnë blerjen e duhanit direkt nga fermerët.


10.

Perceptimet dhe opinionet publike për tregun gri

- Dy të tretat e qytetarëve në Kosovë pajtohen se tregu gri i produkteve të duhanit shkakton **dëme thelbësore në buxhetin e shtetit**, dhe 56 përqind e tyre mendojnë se tregu gri i produkteve të duhanit shkakton gjithashtu **dëme të konsiderueshme në shoqëri** [Figura 10.1.].
- Një në dy anketues pranon se ekziston një lidhje midis tregut gri të duhanit dhe formave të tjera të krimit, dhe mendon se **tregu gri i produkteve të duhanit shkakton një rrijte të formave të tjera të krimit**.
- Rreth 45 përqind e qytetarëve mendojnë se **tregu gri i duhanit nuk shkakton humbje punësh** në Kosovë.
- Shumica e të anketuarve në Kosovë [66 përqind] kanë imazh negativ në lidhje me kontrabandimin e produkteve të duhanit dhe mendojnë se kjo përbën një pjesë integrale të krimit të organizuar [Figura 10.2.].

Përgjithësisht, shumica e qytetarëve në Kosovë i njohin efektet negative të tregut gri të duhanit.

Figura 10.1. **Tregu gri i produkteve të duhanit shkakton**




Burimi: Të dhënat e anketës.

Humbje të të ardhurave në buxhetin e shtetit prej tregut gri.

Figura 10.2. **Kontrabanda e cigareve dhe duhanit është pjesë e krimit të organizuar**

Dy të tretat e qytetarëve në Kosovë mendojnë se kontrabanda e produkteve të duhanit është krim i organizuar.



Burimi: Të dhënat e anketës.

Shtojca

Tabela A1 **Detajet e anketimit**

Periudha e anketimit	Shkurt – Prill 2018
Popullata e synuar	Popullsia banuese e Kosovës: grupmosha mbi 18, me kuotën e duhanpirësve proporcionale me përqindjen e prevalencës së pirjes së duhanit në vend [35.2 përqind për meshkujt, 16.3 përqind për femrat] Sjelljet e duhanpirësve në Kosovë: Rezultatet e Steps Survey; https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC5504541/
Modeli i dizajnit	Marrjen e mostrave të rastësishme Mostra përfaqësuese kombëtare
Kontrolli i cilësisë	Kontrolli i cilësisë së mbledhjes së të dhënave bëhet duke ri-kontaktuar të anketuarit dhe duke pyetur pyetjet e përzgjedhura me përgjigjet nga intervista fillestare. Një minimum prej 25% për intervistuesit kontrollohet. Kontrollet logjike të kryera në grupin e të dhënave përfundimtare
Madhësia neto e modelit	3.000
Shkalla e përgjigjeve	62.0%
Metoda	CATI [Intervista Telefonike me Ndihmë Kompjuterike]

